



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2022

**VENDIM**

**Nr. 232, datë 23.06.2022**

**PËR**

**CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

**VENDOSI:**

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR GJIROKASTËR**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, Fatmir Ndreu, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Të pandehur: {...}, {...}, {...}, {...}; Objekti: Dërgimi i çështjes në gjyq.

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PËRMET**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Seladin Pysqyli (relator), Besnik Shehu dhe Ervin Sulaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Të pandehur: {...} etj.; Akuza: Neni 283/2 dhe 278/6, 300 të Kodit Penal.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Blerta Çibuku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Të pandehur: {...}; Akuza: Neni 283/2 të Kodit Penal.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Luljeta Kole, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Të pandehur: {...} etj.; Akuza: Neni 283/2 dhe 278/6, 300 të Kodit Penal; Objekti: Dërgimi i çështjes në gjyq.

### **GJYKATA E APELIT KORÇË**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Ornela Naqellari, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Dhunë në familje, largim i të burgosurit nga vendi i qëndrimit; Viktima e veprës penale: {...}.

2. Gjyqtaret e Gjykatës së Apelit Tiranë, Ornela Naqellari dhe Elona Mihali, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: ‘Ngacmim seksual’; Viktima e veprës penale: {...}.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Ornela Naqellari, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Të pandehur: {...}, {...}, {...}; Akuza: Ndhimë për kalim të paligjshëm të kufirit, Mosbindje ndaj urdhërit të punonjësit të policisë së rendit publik, Vjedhje.

4. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Elona Mihali, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Kanosje për shkak të detyrës, Keqpërdorimi i thirrjeve telefonike; Viktima nga vepra penale: {...}.

### **GJYKATA E APELIT SHKODËR**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Alma Ahmeti, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}, etj; Objekti: Plotësim vendimi.

### **GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, Laurent Fuçia dhe Iliba Bezati, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}, {...}, {...}; Akuza: Kultivimi i bimëve narkotike.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Genti Dokollari, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen civile me Paditës: {...}; Të paditur: {...}, {...}, etj; Objekti: Shfuqizim vendimi nr.{...}te ish ZRKKP Vlorë, etj.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**